

Me rastin e Asamblesë së nëntë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Pejë më 11 mars 2010

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë:

Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Gerrit-Marc Sprenger, Anna Bednarek, Arkadiusz Sedek, Charles Smith, Gabriele Gaube, Emilio Gatti, Esma Erterzi, Francesco Florit, Guy Van Craen, Harri Katara, Klaus Jung, Klaus Huner, Johanna Schokkenbroek, Laura Plesa, Nikolay Entchev, Piero Leanza, Richard Winkelhofer, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vitor Pardal, Vladimir Kanev, Vergiinia Micheva-Ruseva.

Merr VENDIMIN

Njëzëri, që të miratojë këtë Rekomandim mbi përkufizimin e “lëndëve që lidhen me pronën”.

Maria Giuliana Civinini
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

REKOMANDIM

Duke u mbështetur në Nenin 4.10 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – LmK- dhe në Nenin 8 të Rregullave të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Asambleja

U r e k o m a n d o n

Gjyqtarëve, zyrtarëve dhe këshilltarëve ligjorë të EULEX-it

Që të interpretojnë shprehjen “lëndët civile që lidhen me pronën” në Nenin 5.1 c) të LmK-së në atë mënyrë që të ketë këto kuptime:

-Lëndët me patundshmëri dhe ato të “përziera” (që kanë të bëjnë përveç me pronën e patundshme, edhe me lëndë të tjera të kërkesave, siç janë pronat e luajtshme apo integriteti fizik)

-kudo ku ka kontestim të

(1) së drejtës in rem p.sh. të rregulluar si në Ligjin mbi marrëdhëniet themelore juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80, e botuar në Përmbledhjen III të QJK-së, dhjetor 2000) dhe në Ligjin Nr. 03/L-154 mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 57, 4 gusht 2009, faqe 1),

(2) të drejtës së banimit në kuptim të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së Nr. 11/83, 29/86, 42/86 e botuar në Përmbledhjen e përmendur të QJK-së) ose

(3) të drejtave të tjera të pronës shoqërore apo shtetërore në kuptim të nenit 2.2 (d) të Ligjit Nr. 2002/5 mbi themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 34, 1 gusht 2008, faqe 54)

- dhe kërkesat për kompensim të bazuara në shkeljen apo humbjen e një prej të drejtave të lartpërmendura apo në pengimin e paligjshëm për realizimin e një drejte të tillë.